

*Oda e Mjekëve e Maqedonisë*



**RREGULLORE**

**për mënyrën e dhënies, vazhdimin, ripërtëritjen dhe heqjen e licencës së punës, të formës dhe përmbajtjes së formularit të licencës në punë të punonjësve shëndetësorë në fushën e mjekësisë**

## **Shkurt, 2017**

Në bazë të nenit 135, të Ligjit të Mbrojtjes Shëndetësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/2012, 145/2012, 65/2013, 87/2013, 164/2013, 39/2014, 43/2014, 101/2014, 132/2014, 188/2014, 10/2015 dhe 61/2015) dhe nenit 14, të Statutit të Odës së Mjekëve të Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 24/95, 30/95, 22/96 dhe 36/00), Kuvendi i Odës së Mjekëve të Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 10.11.2016, 17.11.2016 dhe 23.2.2017, miratoi:

### **RREGULLORE**

**për mënyrën e dhënies, vazhdimin, ripërtëritjen dhe heqjen e licencës së punës, të formës dhe përmbajtjes së formularit të licencës në punë të punonjësve shëndetësorë në fushën e mjekësisë**

#### **I. DISPOZITA E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohen mënyrat e dhënies, vazhimit, ripërtëritjes dhe heqja e licencës për punë të punonjësve shëndetësorë me arsim të lartë të kryer në fushën e mjekësisë (në tekstin e mëtejme: doktor i mjekësisë), si dhe formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës së punës.

Licenca për të punuar si doktor i mjekësisë mund të lëshohet, vazhdohet, ripërtërihet dhe të merret sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore dhe në mënyrën e përcaktuar me këtë rregullore.

##### **Neni 2**

Licenca e punës është dokument publik i lëshuar në bazë të autorizimit publik nga Oda e Mjekëve e Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Oda), si dëshmi se doktori i mjekësisë është i aftësuar profesionalisht për kryerjen e pavarur të veprimtarisë shëndetësore.

## **II. MËNYRA E LËSHIMIT TË LICENCËS SË PUNËS**

### **Neni 3**

Doktori i mjekësisë, shtetasi i Republikës së Maqedonisë, i cili arsimin e ka kryer në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë,

Oda i jep licencë për punë në bazë të kërkesës me shkrim.

Ndaj kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, doktori i mjekësisë paraqet:

- diplomë për arsim të lartë të kryer në fushën e mjekësisë,
- dëshmi e punës provë të kryer,
- dëshmi e provimit të dhënë profesional, respektivisht
- dëshmi e specializimit të kryer, respektivisht subspecializimit.

Dëshmia nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet në origjinal ose në kopje të noterizuar.

### **Neni 4**

Doktor i mjekësisë, shtetas i Republikës së Maqedonisë, i cili ka kryer arsimin e lartë, ka kryer punë provë dhe ka dhënë provim profesional jashtë vendit,

Oda i jep atij licencë për të punuar në bazë të kërkesës me shkrim.

Ndaj kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, doktori i mjekësisë paraqet:

- diplomë të nostrifikuar për arsimin e lartë të kryer në fushën e mjekësisë,
- dëshmi e njohur e punës provë dhe provim të dhënë profesional, respektivisht
- vërtetim e nostrifikuar për specializim e kryer, respektivisht subspecializimit.

Dëshmitë nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohen në origjinal ose në fotokopje të vërtetuara nga noteri.

### **Neni 5**

Doktorit i mjekësisë - shtetasi i Republikës së Maqedonisë, i cili ka marrë licencë për punë jashtë vendit, Oda i jep licencë për punë, nëse përveç kushteve nga neni 4, të kësaj

rregulloreje ka rekomandim nga Oda, në të cilin ka qenë i anëtarësuar dhe dëshmitar përvojës së mëparshme të punës në veprimtarinë në të cilën kërkon licencë pune.

## **Neni 6**

Doktorit të mjekësisë - shtetasi i huaj, Oda i lëshon licencë për punë, në bazë të kërkesës me shkrim.

Ndaj kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, doktori i mjekësisë paraqet:

- dëshmi e leje qëndrimit të miratuar në Republikën e Maqedonisë të lëshuar nga organi kompetent shtetëror;
- leje pune të lëshuar nga organi kompetent shtetëror,
- diplomë të nostrifikuar e arsimit të lartë të kryer nga fusha e mjekësisë,
- dëshmi e pranuar e punës provë
- dëshmi e provimit të dhënë profesional,
- dëshmi për kryerjen e trajnimit plotësues dhe kontrollimit të njohurive dhe aftësive profesionale, në pajtim me Rregulloren e programit për trajnim plotësues dhe për kontrollimin e njohurive dhe të aftësive profesionale të doktorëve të mjekësisë;
- dëshmi - vërtetim për njohjen e gjuhës maqedonase të lëshuar nga institucioni i autorizuar arsimor për testin e kaluar me sukses për njohjen e gjuhës.

Për doktorin e mjekësisë - shtetasi i huaj që ka fituar kualifikime në shtetet anëtare të Bashkimit Europian ose në Zvicër, Norvegji, Kanada, Japoni, Izrael, Turqi, Rusi ose SHBA, nuk paraqet dëshmi të trajnimit shtesë të kryer dhe verifikimit të njohurive dhe të aftësive profesionale.

Dëshmitë nga paragrafi (1) të këtij neni dorëzohen në origjinal ose në fotokopje të vërtetuar nga noteri.

## **Neni 7**

Doktori i mjekësisë, specialist, respektivisht subspecialist nga vendet anëtare të OECD-së ose shtetas i Maqedonisë, i cili ka punuar së paku pesë vjet pa ndërprerje në institucione shëndetësore, respektivisht institucione të arsimit të lartë në fushën e mjekësisë në vendet anëtare të OECD-së, si dhe drejtues i një institucioni shëndetësor në vendet anëtare të OECD-së, në pajtim me rregulloret në fushën e studimeve mjekësore dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të doktorëve të mjekësisë, Ministria e Shëndetësisë ka lidhur kontratë për kryerjen e veprimtarisë mjekësore si punonjës shëndetësor në institucion publik shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të aftësive dhe njohurive të doktorëve të mjekësisë, specialistëve dhe

subspecialistëve në institucionet publike shëndetësore në Republikën e Maqedonisë, përmes bartjes së shkathtësive dhe njohurive në fushën e mjekësisë dhe punës në institucione shëndetësore, Oda në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë lëshon licencë të përkohshme për punë.

Licenca për punë nga paragrafi (1) i këtij neni lëshohet me kërkesë të institucionit shëndetësor ku eksperti do të kryejë veprimtarinë e përkohshme shëndetësore. Ndaj kërkesa shoqërohet me:

- biografi profesionale,
- përshkrim i detajuar i qëllimeve dhe kohëzgjatja e qëndrimit të ekspertit,
- licenca e punës e lëshuar nga vendi i origjinës; dhe
- vërtetim nga institucioni shëndetësor për marrjen e përgjegjësisë se institucioni do të ofrojë kujdes shëndetësor përkatës për pacientët e diagnostikuar pas largimit të specialistit të ftuar.

### **Neni 8**

Doktorit të mjekësisë - specializant i lartë, Oda i jep licencë të përkohshme pune, pas përfundimit të vitit të tretë të praktikës specialistike, në bazë të kërkesës me shkrim.

Ndaj kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, doktori i mjekësisë paraqet:

- diplomë për arsimin përkatës të përfunduar në fushën e mjekësisë,
- dëshmi për provimin e dhënë profesional,
- dëshmi për dhënien e provimit intermedial, dhe
- dëshmi për realizimin e përvojës së specializuar trevjeçare.

Dëshmia nga paragrafi (2) i këtij neni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të vërtetuar nga noteri.

Oda e Mjekëve e Maqedonisë e lëshon licencën e përkohshme për të punuar si specializant i lartë në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së specializantit.

### **Neni 9**

Kërkesat nga nenet 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje, me të gjitha dëshmitë e paraqitura dorëzohen në Odën e Mjekëve të Maqedonisë.

### **Neni 10**

Licenca e lëshuar e punës është e vlefshme për shtatë vjet nga dita e lëshimit, në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore.

Në formularin e lejes së punës së shtetasit të huaj, si kohë e vlefshmërisë së lejes së punës shënohet koha e vlefshmërisë së lejes së qëndrimit në Republikën e Maqedonisë dhe vazhdon me paraqitjen e dëshmisë për vazhdimin e vendbanimit të lëshuar nga organi kompetent shtetëror.

Periodha shtatëvjeçare e vlefshmërisë së licencës së punës nga paragrafi (1) i këtij neni fillon nga data e lëshimit të licencës së parë.

Nëse licenca e punës nga paragrafi (2) i këtij neni nuk vazhdohet, në Regjistrin e licencave të lëshuara, të ripërtërira, të vazhduara dhe të hequra në rubrikën, licencë e vazhduar, shënohet se licenca nuk është vazhduar.

Licencat e lëshuara regjistrohen në Regjistrin e licencave të lëshuara, të ripërtërira, licenca të vazhduara dhe të hequra që mbahen nga Oda.

### **III. MËNYRA E RIPËRTRIRJES SË LICENCËS SË PUNËS**

#### **Neni 11**

Doktori i mjekësisë paraqet kërkesë për ripërtëritjen e licencës së punës të paktën 30 ditë para skadimit të afatit të vlefshmërisë së licencës së punës.

Ndaj kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, doktori i mjekësisë i bashkëngjit:

-dëshmi se në periudhën e vlefshmërisë së licencës së punës ka fituar numër të mjaftueshëm pikësh në pajtim me aktin nënligjor, që rregullon format e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, kriteret për vendosjen e formave të përsosjes së vazhdueshme profesionale, dhe

- vërtetim se të paktën 60% të kohës së vlefshmërisë së licencës së punës ka punuar në veprimtarinë për të cilën ka licencë pune.

#### **Neni 12**

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, Oda pasi konstaton se janë plotësuar kërkesat e Ligjit të Mbrojtjes Shëndetësore, ja ripërtërin licencën për punë doktorit të mjekësisë, duke i lëshuar licencë për punë me numrin origjinal dhe shenjën shtesë për vazhdim.

Periodha e re e vlefshmërisë së licencës së ripërtëritjes është shtatë vjet.

Licenca e ripërtërirë regjistrohet në Regjistrin e licencave të lëshuara, të ripërtërira, të vazhduara dhe të hequra për punë.

#### IV. MËNYRA E VAZHDIMIT SË LICENCËS SË PUNËS

##### **Neni 13**

Licenca për punë e doktorit të mjekësisë, i cili në periudhën e vlefshmërisë së licencës nuk i ka plotësuar kushtet për ripërtëritjen e licencës sipas Ligjit të Mbrojtjes Shëndetësore, vlefshmëria e licencës mund të vazhdohet përkohësisht për një periudhë prej 6 muajsh, nëse në atë periudhë bëhet trajnimi plotësues dhe kontrollimi i njohurive dhe shkathtësive profesionale, në pajtim me Rregulloren për programin për trajnim plotësues dhe kontrollimin e njohurive dhe aftësive profesionale të doktorëve të mjekësisë. Licenca e punës e vazhduar përkohësisht përmban të njëjtin numër regjistrimi dhe periudhën për të cilën është vazhduar.

Doktorit të mjekësisë i cili nuk i ka plotësuar kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni i hiqet përkohësisht licenca për punë.

##### **Neni 14**

Doktorit të mjekësisë, të cilit i është hequr përkohësisht licenca për punë, mund të marrë përsëri licencë për punë gjatë një viti të llogaritur nga vlefshmëria e aktvendimit për heqjen e përkohshme të licencës për punë, nëse kryen trajnim shtesë dhe kontroll të njohurive profesionale dhe aftësitë, në pajtim me Rregulloren për programin e trajnimit plotësues dhe verifikimin e njohurive dhe trajnimeve profesionale të doktorëve të mjekësisë.

#### V. MËNYRA E HEQJES SË LICENCËS SË PUNËS

##### **Neni 15**

Oda mund ta heqë përkohësisht ose përgjithnjë licencën për punë për arsye të përcaktuara në nenin 132, të Ligjit të Mbrojtjes Shëndetësore.

Me aktvendimin për heqjen e përkohshme të licencës së punës përcaktohet kohëzgjatja e ripërtëritjes së licencës dhe përcaktohet trajnimi plotësues, që duhet të kryhet në pajtim me nenin 127 të Ligjit të Mbrojtjes Shëndetësore.

Aktvendimi për heqjen e licencës regjistrohet në regjistër dhe botohet në gazetën e Odës

## VI. MARRJA E SËRISHME E LICENCËS SË PUNËS

### Neni 16

Doktori i mjekësisë të cilit i është hequr përkohësisht licenca e punës, mund të marrë sërish licencë pune nëse brenda dy viteve nga vlefshmëria e aktvendimit për marrjen e përkohshme të licencës së punës, e kryen me sukses trajnimin shtesë dhe verifikimin e njohurive profesionale dhe aftësitë në pajtim me Rregulloren për programin për trajnim plotësues dhe kontrollimin e njohurive dhe aftësive profesionale të doktorëve të mjekësisë dhe ka paraqitur kërkesë me shkrim për marrjen e licencës për punë.

## VII. FORMA DHE PËRMBAJTJA E LICENËS SË PUNËS

### Neni 17

Licenca për punë, lëshohet në formular që ka formë drejtkëndëshi me përmasa 25 x 35 cm. Licenca për punë, përveç formularit nga paragrafi (1) i këtij neni mund të lëshohet në formular, në formë drejtkëndëshi me përmasa 8,5 x 5,5 cm.

### Neni 18

Licenca për punë lëshohet në formular nr.1, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregullore dhe nga lart – poshtë përmban: në mes është teksti: stema e “Republikës së Maqedonisë” poshtë saj qëndron: ”Oda e Mjekëve e Maqedonisë lëshon”, pastaj në qendër: “Licencë për punë”; poshtë saj qëndron: “ emri, emri i babait, mbiemri” me vend për shënimin e të dhënave; më pas vijon “Numri i regjistrimit” me vend për shënimin e numrit të licencës, poshtë tij është teksti: “licenca e punës është e vlefshme deri më”, me vend për shënimin e të dhënave. Më poshtë është teksti: “data e dorëzimit të kërkesës, Shkup”. Në fund majtas është teksti: “Kryetari i Komisionit të Etikës dhe Çështjeve Juridike” dhe më poshtë ka hapësirë për nënshkrimin e kryetarit të Komisionit të Etikës dhe Çështjeve Juridike, a poshtë djathtas është teksti “Kryetari i Odës së Mjekëve të Maqedonisë” dhe poshtë asaj vendi zbrazur ku kryetari duhet të nënshkruajë; në qendër poshtë qëndron “V.V.”



## VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### **Neni 19**

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon të vlejë Rregullorja për mënyrën e dhënies, vazhdimin, ripërtëritjen dhe heqjen e licencës për punë të punonjësve shëndetësorë me arsim të lartë të kryer në fushën e mjekësisë (“Gazeta Zyrtare e Republika së Maqedonisë” nr. 72/5 dhe 69/9).

### **Neni 20**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, dhe do të publikohet pas pëlqimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Nr.2 - 3969/19

1.3.2017

Shkup

Kryetari i

Odës së Mjekëve të R. së Maqedonisë

Prof. dr. - Koço Çakalaroski

*ODA E MJEKËVE E MAQEDONISË*

*LËSHON*

*LICENCË PËR PUNË*

---

*Emri, emri i babait dhe mbiemri*

---

*fusha profesionale për të cilën është lëshuar licenca*

*Numri i regjistrimit*

*Licenca e punës vlen deri më \_\_\_\_\_*

*Data e paraqitjes së kërkesës*

*Shkupi*

*Kryetari i Komisionit  
të Çështjeve Etike dhe Juridike*

*Kryetari i  
Odës së Mjekëve të Maqedonisë*

*V.V.*

